


Raporti i vitit 2018 mbi trafikimin e personave

KOSOVA: Niveli 2

Qeveria e Kosovës nuk i përmbush plotësisht standardet minimale për eliminimin e trafikimit; megjithatë, ajo është duke bërë përpjekje të mëdha për ta bërë këtë. Qeveria demonstroi përpjekje të shtuara në krahasim me periudhën paraprake të raportimit; prandaj, Kosova mbeti në Nivelin 2. Qeveria demonstroi përpjekje të shtuara duke lëshuar udhëzime për identifikim proaktiv të viktimave dhe duke kryer hetime proaktive me inspektorët e punës, prokurorët dhe punëtorët socialë. Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit gjithashtu caktoi një koordinator të posaçëm për çështje të trafikimit dhe themeloi në databazë të re për t'i monitoruar rastet e trafikimit. Megjithatë, Qeveria nuk i përmbushi standardet minimale në disa fusha kryesore. Gjykatësit shqiptuan dënime të buta për trafikantët e dënuar dhe prokurorët vazhduan t'i ulnin rastet e trafikimit në krime më të vogla. Qeveria e zvogëloi financimin për strehimoret e drejtuara nga OJQ-të dhe kishte mekanizma jokonsistentë të financimit, duke shkaktuar kështu që një strehimore e drejtuar nga OJQ-të të mbyllej përkohësisht.



REKOMANDIMET PËR KOSOVËN

Energjikisht t'i hetojë, ndjekë penalisht dhe dënojë trafikantët, përfshirë zyrtarët bashkëfajtorë, dhe të shqiptojë dënime më të rrepta; të sigurojë financim adekuat dhe konsistent për strehimoret e drejtuara nga OJQ-të; të caktojë prokurorë dhe gjykatës specifike për t'i trajtuar rastet e trafikimit; t'u ofrojë gjykatësve, prokurorëve dhe organeve për zbatim të ligjit trajnime të avancuara për hetimin dhe ndjekjen penale të trafikimit; t'i trajnojë zyrtarët për kontroll të trafikimit ndër individët e përfshirë në prostitucion, migrantë, refugjatë dhe popullata të tjera të rrezikuara; dhe t'i zbatojë në mënyrë uniforme protokollet e tilla; të hartojë udhëzime me shkrim dhe t'i rrisë përpjekjet për t'i identifikuar dhe për t'u ndihmuar fëmijëve që i nënshtrohen lypjes së detyruar; ta pakësojë numrin e rasteve të pazgjidhura, përfshirë rastet që lidhen me trafikimin; të punojë me autoritetet lokale për të themeluar strehimore në komunat veriore; ta standardizojë mbledhjen e të dhënave dhe ta krijojë një databazë që i zbërthen statistikën për trafikim dhe ndjekje penale e dënime për raste të lidhura me trafikimin; dhe ta rrisë mbështetjen qeveritare për trajnim të hollësishëm profesional dhe shërbime të riintegritimit për viktimë.

NDJEKJA

Qeveria i shtoi përpjekjet për zbatimin e ligjit. Neni 171 i Kodit Penal të Kosovës e kriminalizon trafikimin për qëllime seksuale dhe punë, dhe përcakton dënime prej 5 deri në 12

vjet burg dhe gjobë. Këto dënime ishin mjaft të rrepta dhe, sa i përket trafikimit për qëllime seksuale, në përputhje me dënimet e përcaktuara për krime të tjera të rënda, si dhunimi. Autoritetet paraqitën 21 kallëzime penale për trafikim në vitin 2017 (31 në vitin 2016). Organet për zbatimin e ligjit arrestuan 28 të dyshuar për trafikim (62 në vitin 2016) dhe 10 të dyshuar të tjerë për “shfrytëzim të shërbimeve seksuale nga viktima e trafikimit” (18 në vitin 2016). Qeveria nuk i zbërtheu krimet e trafikimit dhe krimet e lidhura me trafikimin për statistika për ndjekje penale dhe dënim, me gjasë duke inkorporuar rastet që nuk ishin trafikim, si “mundësimi i prostitucionit”, “lehtësimi ose detyrimi për prostitucion”, abuzimi seksual i fëmijëve dhe pornografia e fëmijëve. Qeveria ndoqi penalisht 27 të pandehur (56 në vitin 2016), përfshirë një të pandehur për “shfrytëzim të shërbimeve seksuale nga viktima e trafikimit”. Gjykatat i dënuan 29 trafikantë (24 në vitin 2016). Gjykatësit vazhduan të shqiptonin dënime nën dënimin minimal prej pesë vjetësh burg. Një trafikant u dënua me 5 vjet burg dhe një gjobë prej 5.000 eurove (6.000 dollarë), dhe 14 trafikantë u dënuan prej 18 muaj deri në tri vjet e shtatë muaj burg, por shtatë trafikantë morën dënime me kusht dhe shtatë të tjerë u dënuan me gjoba që silleshin prej 600 eurove (720 dollarë) deri në 3.600 euro (4.320 dollarë). Gjykatat nuk e pakësuan numrin e rasteve të pazgjidhura të trafikimit; 88 raste nga vitet paraprake mbetën të hapura. Vëzhguesit raportuan se mos-specializimi i pjesës dërrmuese të prokurorëve dhe gjykatësve rezultoi në dënime më të buta ose në raste të uljes në krim më të vogël, posaçërisht të rasteve që përfshinin kontrollin emocional dhe detyrimin psikologjik të viktimës. Qeveria shkëmbeu informata me qeveritë e huaja në 22 raste të trafikimit, kreu hetime të përbashkëta me Shqipërinë dhe nënshkroi një marrëveshje për ekstradim me Hungarinë.

Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore (DHTQNJ) e Policisë së Kosovës (PK) i ka hetuar të gjitha rastet e trafikimit me tetë njësi rajonale. DHTQNJ themeloi një njësi në katër komunat veriore, një rajon që kohët e fundit u integrua në sistemin gjyqësor të Kosovës. DHTQNJ kreu hetime të përbashkëta me prokurorët dhe nëpunësit socialë dhe koordinoi punën me Inspektoratin e Punës për të kryer 143 inspektime të përbashkëta të bareve, klubeve të natës, restoranteve dhe lokaleve të masazhit (120 në vitin 2016). Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) caktoi një koordinator special për trafikim, shtoi dy prokurorë dhe themeloi në databazë të re për t’i monitoruar rastet e trafikimit. Departamenti i PK-së për trajnim, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, mbajti 31 trajnime për 83 hetues të DHTQNJ-së. Qeveria i trajnoi prokurorët në praktikat më të mira për ndjekje penale dhe ndihmë viktimave për të kërkuar kompensim dhe i trajnoi gjykatësit dhe avokatët e viktimave në çështje të trafikimit. Megjithatë, shumë prokurorë, të trajnuar sipas Kodit Penal të Jugosllavisë, kishin nevojë për trajnim të mëtejshëm në Kodin Penal të Kosovës.

DHTQNJ, ZKPSH dhe Inspektorati i PK-së bashkëpunuan për t’i hetuar nëpunësit zyrtarë të qeverisë që ishin bashkëfajtorë në krime të trafikimit me njerëz, por nuk raportuan për ndjekje penale apo dënime. Korrupsioni dhe bashkëfajësia zyrtare në krime të trafikimit mbetën shqetësime të mëdha, gjë që i pengonin veprimet e organeve për zbatim të ligjit gjatë vitit. Në vitin 2016, prokurorët akuzuan dy policë në raste të veçanta për keqpërdorim të dyshuar të pozitës zyrtare dhe shfrytëzim seksual të viktimave të trafikimit. Gjykimet ishin në vazhdim e sipër në fund të periudhës së raportimit. Në vitin 2014, gjykatat i dënuan dy zyrtarë të Ministrisë së Punës për keqpërdorim të pozitës zyrtare, për lëshim të lejeve të punës për 22 punëtorë të huaj, të identifikuar më vonë si viktima të trafikimit, dhe i gjobitën secilin me nga 3.000 euro (3.600 dollarë); megjithatë, Gjykata Themelore i liroi të dy zyrtarët dhe u lejoi ta vazhdonin punën e tyre zyrtare. Në vitin 2016, prokurorët parashtruan ankesë kundër lirimit të tyre, por Gjykata e Apelit e refuzoi këtë ankesë dhe e konfirmoi rastin si aktgjykim të formës së prerë.

MBROJTJA

Qeveria i shtoi përpjekjet për mbrojtjen e viktimave. Qeveria identifikoi 32 viktime të trafikimit (36 në vitin 2016). Prej tyre, 18 ishin viktime të trafikimit seksual, shtatë ishin viktime të punës së detyruar, tri ishin viktime të lypjes së detyruar dhe katër ishin viktime të “robërisë dhe skllavërisë” (26 ishin viktime të trafikimit seksual, nëntë ishin viktime të punës së detyruar, dhe një ishte viktimë e “robërisë dhe skllavërisë” në vitin 2016); 19 ishin fëmijë (18 në vitin 2016); 29 ishin femra dhe tre ishin meshkuj (34 femra dhe dy meshkuj në vitin 2016); 25 ishin nga Kosova, pesë nga Shqipëria, një nga Filipinet dhe një nga Moldavia. Qeveria miratoi një listë të indikatorëve të trafikimit për t’u ndihmuar organeve për zbatim të ligjit dhe ofruesve të shërbimeve sociale në identifikimin proaktiv të viktimave; megjithatë, vëzhguesit raportuan për mungesë të udhëzimeve dhe përpjekje proaktive për identifikim të viktimave të lypjes së detyruar, posaçërisht fëmijëve. Një mekanizëm shumë-disiplinor kombëtar i referimit (MKR) ofroi procedura standarde të operimit (PSO) për identifikimin dhe referimin e viktimave në shërbime. MKR-ja kërkonte që një hetues nga DHTQNJ-ja dhe një avokat i viktimave nga Zyra për Ndihmë dhe Avokim të Viktimave të mblidheshin dhe t’i vlerësonin viktimat si rrezik i ulët, i mesëm ose i lartë, dhe ta koordinonin kujdesin dhe vendosjen e viktimave. PSO-të kërkonin që një nëpunës social të kujdesej për viktimat fëmijë. Vëzhguesit raportuan se MKR-ja funksiononte mirë dhe theksuan bashkëpunimin e mirë midis akterëve.

Qeveria licenoi dhe pjesërisht financoi dy strehimore të drejtuara nga OJQ-të për të ofruar shërbime për viktime të trafikimit, bashkë me Objektin për Siguri të Përkohshme (OSP), të drejtuar nga shteti. Këto strehimore ofronin ndihmë juridike, shërbime mjekësore e psikologjike, këshillim, arsim, shërbime rekreative dhe mbështetje tjetër rehabilituese. Viktimat gjithashtu kishin qasje në nëntë objekte kujdesi të MPMS-së, por qeveria nuk kishte objekt kujdesi në katër komunat veriore të vendit. OSP i strehonte përkohësisht viktimat e trafikimit të vlerësuar si rrezik i lartë. Autoritetet kërkonin që viktimat të kishin përcjellje policore jashtë strehimores gjersa procedurat gjyqësore ishin në vazhdim e sipër dhe kërkonin miratim nga prokurori dhe PK-ja për viktimat për t’u larguar përgjithmonë nga OSP-ja gjersa vlerësoheshin si rrezik i lartë. Objekti kishte kapacitet t’i strehonte 40 persona në dhoma të veçanta për femra, meshkuj dhe familje. Viktimat qëndronin në OSP mesatarisht 90 ditë para se të transferoheshin në një strehimore të drejtuar nga OJQ-të. OSP strehoi 35 viktime, përfshirë pesë viktime të mundshme dhe dy viktime të identifikuara në vitin 2016. Dy strehimore të drejtuara nga OJQ-të ofronin shërbime mbështetëse për viktimat e vlerësuar rrezik i ulët - i mesëm; njëra nga këto strehimore të drejtuara nga OJQ-të ishte vetëm për fëmijë. Vëzhguesit raportuan se programet për riintegrim përballeshin me sukses të kufizuar për shkak të mungesës së burimeve dhe papunësisë së lartë. Qeveria ndau 152.870 euro (183.520 dollarë) për mbrojtje të viktimave, krahasuar me 171.010 euro (205.290 dollarë) në vitin 2016. Qeveria vazhdoi ta ulte financimin për strehimoret e drejtuara nga OJQ-të; strehimoret e drejtuara nga OJQ-të morën 72.870 euro (87.480 dollarë), krahasuar me 91.010 euro (109.260 dollarë) në vitin 2016 dhe 101.930 euro (122.360 dollarë) në vitin 2015. OSP mori 80.000 euro (96.040 dollarë) në vitin 2016 dhe 2017. Strehimoret e drejtuara nga OJQ-të raportuan se financimi nga qeveria nuk ishte i mjaftueshëm dhe operacionet nuk do të mund të vazhdonin pa ndihmë financiare nga donatorët e huaj. MPMS kërkonte aplikacione për fonde çdo gjashtë muaj, duke shkaktuar kështu boshllëk në financim, gjersa aplikacionet të procesoheshin dhe miratoheshin. Një strehimore e drejtuar nga OJQ-të u mbyll përkohësisht për një muaj për shkak të vonësës së thirrjeve nga MPMS-ja për aplikacione për financim.

Nuk pati raportime që viktimat ishin ndëshkuar për veprime të paligjshme të kryera si rezultat i drejtpërdrejtë i të qenët i nënshtruar ndaj trafikimit me qenie njerëzore. Qeveria i inkurajonte viktimat të merrnin pjesë në procese hetuese e gjyqësore, duke siguruar mbrojtje në OSP, strehim dhe kujdes në objekte të tjera, dhe pjesëmarrje në programet për mbrojtjen e

dëshmitarëve. Të 32 viktimat morën pjesë në hetimet dhe procedurat gjyqësore. Ligji u jep të drejtën viktimave të huaja për një periudhë reflektimi prej 30 deri në 90 ditë pas identifikimit gjatë të cilës viktimat mund të rimëkëmben para se të vendosin nëse do të bashkëpunojnë me organet për zbatim të ligjit. Qeveria raportoi se trafikantët e dyshuar nuk ishin të pranishëm kur viktimat jepnin deklaratat dhe viktimat e huaja mund të ktheheshin në vendet e tyre të prejardhjes pasi të dëshmonin, pa pritur për përfundim të gjykimit. Ligji u jep të drejtë viktimave të huaja për leje qëndrimi të përkohshëm për së paku gjashtë muaj; një viktimë mori leje (dy në vitin 2016). Qeveria ia ndau 100.000 euro (120.050 dollarë) fondit për kompensim të viktimave të krimit dhe themeloi një komision kompensimi për t'i shqyrtuar kërkesat; viktima e parë e trafikimit u kompensua në dhjetor të vitit 2017 me rreth 5.000 euro (6.000 dollarë).

PARANDALIMI

Qeveria i vazhdoi përpjekjet për ta parandaluar trafikimin. Agjencia kombëtare kundër trafikimit të personave (AKKTP) i koordinoi përpjekjet mes agjencive dhe mbante mbledhje mujore për ta monitoruar zbatimin e Planit kombëtar për veprim (PKV) kundër trafikimit 2015 – 2019. Qeveria nuk raportoi për shumën e fondeve të ndara për zbatimin e PKV-së në vitin 2016 ose 2017, krahasuar me 288.000 euro (345.740 dollarë) në vitin 2015. OJQ-të raportuan për bashkëpunim shumë të mirë me AKKTP-në dhe koordinatorin kombëtar, përfshirë reagimin ndaj rekomandimeve dhe shqetësimeve. Qeveria vazhdoi fushatën vjetore njëmuajore që synonte viktimat e mundshme të trafikimit; 28 prej 38 komunave ndanë fonde për të marrë pjesë në këtë fushatë vetëdijesimi. Qeveria shpërndau pamflete në pikat kufitare me Shqipërinë me informata se si të kërkohet ndihmë dhe mbajti ligjëratat në çështje të trafikimit. Linja e drejtpërdrejtë telefonike, e drejtuar nga qeveria, pranoi 907 thirrje, përfshirë shtatë raste të trafikimit të mundshëm që shpuren në dy hetime. Qeveria prodhoi një video se si qytetarët mund ta ulin kërkesën për punë të dhunshme, por nuk raportoi për përpjekjet për ta ulur kërkesën për akte të seksit komercial. Qeveria ofroi trajnim kundër trafikimit për personelin e vet diplomatik dhe ua dha një doracak për t'u ndihmuar në identifikimin e viktimave të trafikimit.

PROFILI I TRAFIKIMIT

Siç është raportuar gjatë pesë vjetëve të fundit, Kosova është burim dhe destinacion për burra, gra dhe fëmijë që i nënshtrohen trafikimit për seks dhe punë të detyruar. Shumica e viktimave trafikohen brenda vendit për shfrytëzim seksual. Shumica e viktimave të trafikimit seksual në Kosovë janë vajza, edhe pse grupet kriminale të Kosovës i detyrojnë gratë nga Shqipëria, Moldavia, Rumania, Serbia dhe vende të tjera evropiane të merren me prostitucion. Gratë dhe vajzat i nënshtrohen trafikimit seksual në shtëpi dhe banesa private, në klube të natës dhe lokale të masazhit. Fëmijët nga Kosova, Shqipëria dhe vende të tjera fqinje detyrohen të lypin brenda vendit. Trafikantët i nënshtrojnë qytetarët e Kosovës në prostitucion të detyruar dhe punë të detyruar në mbarë Evropën. Komunitetet e marginalizuara të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve janë të cenueshme nga lypja e detyruar dhe trafikimi për seks. Korrupsioni qeveritar krijon një mjedis që mundëson disa krime trafikimi. Disa policë, nëpunës të Ministrisë së Punës dhe zyrtarë të tjerë të qeverisë janë akuzuar ose dënuar për krime të trafikimit.